



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



2021

**VIT I OPERACIONIT TË PARË TË FSK PËR
PAQEN, STABILITETIN DHE SIGURINË GLOBALE**



Prishtinë, dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

VITI 2021- VITI I VIZIONIT TË QARTË PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETET TONA USHTARAKE.....	3
KOSOVA NË MESIN E VENDEVE PRITËSE DHE TRUPAT E FSK-SË PJESËMARRËSE NË STËRVITJEN ME TË MADHE AMERIKANE NË EVROPË "DEFENDER-EUROPE'21"	4
FSK SHTON RADHËT ESAJ ME 400 USHTARË TË RINJ.....	6
KONKURSI PËR PRANIMIN E 840 USHTARËVE AKTIVË NË FSK- KONKURSI MË I MADH DERI TANI	6
FSK ME KONKURS PËR REKRUTIMIN E KANDIDATËVE TË RINJ NË AKADEMINË USHTARAKE WEST POINT, AKADEMINË E FORCAVE AJRORE DHE AKADEMINË E FORCAVE DETARE TË SHBA-SË.....	7
BETOHET GJENERATA 2025 E KADETËVE TË RINJ TË FSK-SË.....	7
GJENERAL BASHKIM JASHARI EMËROHET KOMANDANT I RI I FSK-SË DHE AVANCOHET NË GRADË GJENERALLEJTËNANT	8
INTERESIMI I GRAVE DHE VAJZAVE PËR TË QENË PJESË E FSK-SË NË RRRITJE GJATË VITIT 2021.....	9
PAQJA DHE SIGURIA E QËNDRUESHME GARANTOHEN VETËM ME PJESËMARRJE TË PLOTË E TË BARABARTË TË GRAVE	9
NGJARJE HISTORIKE- FLAMURI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS U NGRIT NË MISIONIN E PARË PAQERUAJTËS TË FSK-SË NË KUVAJT.....	10
PËRFAQËSIM DINJITIZOZ NDËRKOMBËTAR I LIDERSHIPIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE FSK-SË	11
THELLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË	16
PËRVJETORI I 23-TË I EPOPESË SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS.....	17
FSK SHEMBULLI PËRKUSHTIMIT DHE ANGAZHIMIT PROFESIONAL NË OPERACIONIN HUMANITAR PËR PRITJEN E REFUGJATËVE AFGANË	18
DONACIONET SI TREGUES I FUQISHËM I PËRKUSHTIMIT TË SHTETEVE MIKE	18
NGA VITI I ARDHSHËM, MINISTRIA E MBROJTJES DO TË KETË MBI 100 MILIONË EURO NË BUXHETIN ESAJ.....	20
REALIZIMI I BUXHETIT PËR MM/FSK PËR VITIN 2021	20
INSPEKTIMI DHE MBIKËQYRJA E SUKSESSHME E ZBATUESHMËRISË SË DETYRIMEVE LIGJORE DHE OPERACIONALE NË MM DHE FSK	20
AUDITIMI I BRENDSHËM ME NDIKIM TË LARTË PËR LLOGARIDHËNIE PARA PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESIT.....	20
BLERJET E REJA, NGRITJA E KAPACITETEVE LOGJISTIKE DHE INFRASTRUKTURE NË FUNKSION TË ARRITJES SË AFTËSIVE OPERACIONALE TË FSK.....	21
INFRASTRUKTURA LIGJORE-KUSHT PËR FUNKSIONIM EFIKAS	21
INTEGRIMI I KOMUNITETEVE JOSHUMICË, OBJEKTIV I PËHERSHËM I LIDERSHIPIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE FSK.....	22
POLITIKAT DHE PLANET STRATEGJIKE TË EFTEKSHME NË ZHVILLIM TË MBROJTJES	22
BASHKËPUNIM I NGUSHTË DHE I SHUMËANSHËM CIVILO - USHTARAK	23
PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUSHT PËR PUNË EFEKTIVE.....	24
TRANSFORMIMI, MODERNIZIMI DHE STANDARDIZIMI-BAZË E USHTRIVE MODERNE.....	24
PROCESI I REKRUTIMIT NË FSK- SUKSESI MADH ZBATIMIN E PLANIT TË TRANZICIONIT PËR FAZËN E PARË.....	24
ARSIMIMI DHE STERVITJA - ME PRIORITET TË LARTË PËR PROFESIONALIZMIN E PJESËTARËVE TË FSK-SË	25
BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME INSTITUCIONE VENDORE NË FUSHËN E MJEKËSISË-AVANCIMI I KAPACITETEVE MJEKËSORE NË FSK.....	25
DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT.....	26
DIPLOMOJNË MJEKËT E PARË TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I MËTEJMË I SISTEMEVE TË KOMUNIKIMIT DHE TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	26
SHËRBIIMI I INTELIGJENCËS DHE SIGURISË GARANCË E PLOTË PËR FUNKSIONIMIN E MINSITRISË SË MBROJTJES DHE OPERACIONALITETIN EFIKAS TË FSK-SË	27
FSK PËR DHJET VJET MË RADHË VLERËSOHET INSTITUCIONI MË I BESUESHËM I SIGURISË.....	27
KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIAT ME PROFESIONALIZËM DHE OBJEKTIVITET TË PLOTË	28
PROKOLLI INSTITUCIONAL DHE SHTETËROR ME STANDARD TË LARTË.....	29



VITI 2021- VIT I VIZIONIT TË QARTË PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETET TONA USHTARAKE

Të nderuar,
Nëpunës e zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes,
Ushtarë, nënoficerë, oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
Ushtarë, nënoficerë, oficerë e zyrtarë të vendeve e forcave partnere,
Bazuar në Programin e Qeverisë, me marrjen e detyrës së Ministrit të Mbrojtjes, përcaktova qëllimet e mia strategjike dhe objektivat e mi operacionale.

Përkundër përballjes me pandeminë COVID-19, me kënaqësi mund të konstatoj se shumica e objektivave, projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021, i kemi realizuar me sukses.

Me sukses arritëm të mirëmbajmë dhe avancojmë edhe më tej aftësitë dhe kapacitetet operacionale aktuale në mbështetje të autoriteteve shtetërore, civile dhe qytetarëve tanë.

Gjithashtu kemi avancuar me sukses edhe në realizimin e aktiviteteve të parapara në procesin e tranzicionit me validimin e kapaciteteve të para funksionale të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial në Stërviçjen më të madhe të forcave amerikane në historinë e rajonit tonë "Defender-Europe'21".

Pas realizimit të kontingjentit prej 400 ushtarëve të rinj, jemi në proces të testimit të kandidatëve edhe për 840 ushtarë të rinj, duke ngritur përqindjen e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë dhe grave e vajzave ushtarake.

Ne do të vazhdojmë të jemi të hapur për të gjitha komunitetet që shprehin vullnetin të bëhen pjesë e FSK-së për të shërbyer në të mirë të vendit dhe qytetarëve pa dallim.

Kemi realizuar procesin e përzgjedhjes së gjeneratës 2025 të kadetëve të Qendrës së Studimeve Universitare, të cilën në shenjë respekti për kontributin e jashtëzakonshëm të gjeneral Clark për Lirinë tonë, gjatë vizitës së tij në Ministrinë e Mbrojtjes, e emëruam zyrtarisht QSU "Wesley Clark".

Krahas planit të arsimimit të stërviçjes brenda vendit kemi realizuar edhe shkollimet, kurset, trajnimet, stërviçjet e garat ndërkombëtare me suksese të jashtëzakonshme të pjesëtarëve dhe njërive tona pjesëmarrëse, të pasuar edhe me kuadrot e reja në proces të përzgjedhjes për West Point, akademinë e forcave ajrore dhe atë detare amerikane.

Krahas vizitave zyrtare të niveleve më të larta në SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Kanada, Turqi, Kroaci, Shqipëri, Letoni e Maqedoninë e Veriut, kemi përfaqësuar Ministrinë dhe Forcat tona në Konferencën e Kartës së Adriatikut, A5-SHBA.

Objektivi tjetër yni është të zhvillojmë edhe më tej forca të ndërveprueshme me forcat e vendeve të NATO-s dhe partnere të saj.

Pas suksesit historik të zbarkimit të parë jashtë vendit në Kuvajt, përkrahë aleatëve tanë të pazëvendësueshëm, forcave amerikane, si dhe mbështetjes së forcave të NATO-s për evakuimin e refugjatëve afgan, së shpejti forcat tona do të angazhohen në operacione të reja jashtë vendit, për të ofruar kontributin tonë edhe më të fuqishëm në të mirën e paqes, stabilitetit dhe sigurisë globale.

Me qëllim të modernizimit të forcave, kemi realizuar pjesën më të madhe të projekteve kapitale të blerjeve të sistemeve të mbrojtjes të përcaktuara për periudhën planifikuese.

Edhe në vitin e ardhshëm synim yni do të jetë angazhimi i fuqishëm për arritjen në dinamikën e planifikuar, të aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së.

Rezultatet e shkëlqyera dhe sukseset tona i vlerësojmë si produkt i angazhimit të përbashkët me partnerët tanë, NALT-in dhe me KFOR-in.

Andaj të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të forcave e vendeve partnere iu shpreh vlerësimin më të lartë dhe mirënjohjen e thellë për angazhimin dhe përkushtimin e lartë.

Ministria dhe Forca jonë edhe këtë vit, për të dhjetën herë me radhë, janë imazhi i besueshmërisë më të lartë qytetare në kuadër të institucioneve të vendit.

Falenderoj nga zemra, forcat tona dhe ushtarët e NATO-s që mbrojnë vendin dhe qytetarët tanë.

Gëzuar Vitin e Ri 2022 me dëshirat më të mira për ju dhe familjet tuaja!

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

Me respekt,

Armend Mehaj



KOSOVA NË MESIN E VENDEVE PRITËSE DHE TRUPAT E FSK-SË PJESËMARRËSE NË STËRVITJEN ME TË MADHE AMERIKANE NË EVROPË "DEFENDER-EUROPE'21"



Gjatë vitit 2021 ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FSK-së kanë vazhuar të ngrisin lart prestigjin e uniformës që bartin, duke nderuar kështu shtetin e ri të Republikës së Kosovës. Përkundër vazhimit me ballafaqimin me pandeminë me COVID-19, FSK ka vazhduar të jetë pjesëmarrëse në gara dhe stërvitje ushtarake përkrah vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s.

Në këtë vit Kosova për herë të parë ishte pjesëmarrëse në stërvitjen ushtarake më të madhe në rajon "Defender-Europe 21", stërvitje kjo e përmasave të mëdha ushtarake amerikane në Evropë dhe Afrikë. Me këtë rast, ushtarët e FSK-së u radhiten përkrah ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s, nën udhëheqjen e partnerit strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Ndërsa në ushtrimin e famshëm ndërkombëtar "Cambrian Patrol 2021" në Mbretërinë e Bashkuar njësi e FSK-së, në konkurrencë me mbi njëqind ekipe të forcave të shteteve të ndryshme të botës, fitoi medaljen e argjendtë. Falë bashkëpunimit të ngushtë bilateral me Mbretërinë e Bashkuar, kjo është hera e katërt që pjesëtarët e FSK-së marrin pjesë duke arritur këtë sukses të jashtëzakonshëm.





Njësitet e FSK-së, gjithashtu gjatë këtij viti kanë marrë pjesë në stërvitjen fushore “Disaster Relief Military Mobility Exercise 2021” me rreth 20 vende anëtare dhe partnere të NATO-s. Ndërsa tjetër e FSK-së, me ftesë të ushtrisë sllovene, ka marrë pjesë në Garën Ushtarake Ndërkombëtare “Skuadra më e mirë 2021”.



Arsimimi dhe stërvitja e pjesëtarëve të FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes, brenda dhe jashtë vendit për vitin 2021 është realizuar, sipas planit.

Shkollime për këtë vit në QSU janë duke i ndjekur 68 kadetë, në shkollime jashtë vendit janë 42 kadetë. Gjatë vitit jashtë vendit janë mbajtur 70 trajnime, ku kanë marrë pjesë 156 pjesëtarë. Në trajnime të brendshme kanë marrë pjesë 1478 pjesëtarë në 68 trajnime të ndryshme. Në gjashtë ushtrime fushore jashtë vendit kanë marrë pjesë 65 pjesëtarë. Janë realizuar pesë gara të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë 38 pjesëtarë. Në trajnimet me IKPA/CIDS kanë marrë pjesë 222 zyrtarët dhe pjesëtarët e MM dhe FSK.

FSK SHTON RADHËT E SAJ ME 400 USHTARË TË RINJ

Sipas Planit paraprak, radhëve të FSK-së iu shtuan edhe 400 ushtarë të rinj të cilët do të shërbejnë me nder si ushtarë dhe ushtare profesioniste në njësitë e tyre.



KONKURSI PËR PRANIMIN E 840 USHTARËVE AKTIVË NË FSK- KONKURSI MË I MADH DERITANI

Ministria e Mbrojtjes në Tetor të këtij viti ka hapur konkursin për rekrutimin e 840 ushtarëve aktivë në FSK. Kjo është hera e parë që në FSK do të pranohen një numër kaq i madh i ushtarëve në një proces.

Ministria e Mbrojtjes, të gjithë të interesuarve, u ka garantuar proces të drejtë dhe transparent, në zbatueshmëri të plotë të procedurave dhe kriterëve ku do të zgjidhen më të mirët prej më të mirëve.



FSK ME KONKURS PËR REKRUTIMIN E KANDIDATËVE TË RINJ NË AKADEMINË USHTARAKE WEST POINT, AKADEMINË E FORCAVE AJRORE DHE AKADEMINË E FORCAVE DETARE TË SHBA-SË

Ministria e Mbrojtjes, në muajin tetor të këtij viti, ka shpallur konkurs për rekrutimin e kandidatëve të rinj për shkollim në akademitë prestigjioze, në Akademinë Ushtarake West Point dhe Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-së. Tashmë



kandidatët që kanë aplikuar janë në proces të testimeve.

Falënderim dhe mirënjohje e përjetshme për SHBA-në për mbështetjen e pa rezervë dhe të pazëvendësueshme për të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë. Gjithashtu, këtë vit, për herë të parë SHBA na ka ofruar edhe mundësinë për studime në Akademinë e Forcave Detare Amerikane. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të interesuarit që plotësojnë kriteret për shkollim në programin akademik të Marinsave të SHBA-së dhe në programin e Sigurisë Kibernetike.



BETOHET GJENERATA 2025 E KADETËVE TË RINJ TË FSK-SË

Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë më 1 tetor të këtij viti është mbajtur ceremonia e betimit të 20 kadetëve të Qendrës për Studime Universitare e FSK-së.

20 të rinj dhe të reja solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së dhe nënshkruan kontratat për shërbim në FSK.



GJENERAL BASHKIM JASHARI EMËROHET KOMANDANT I RI I FSK-SË DHE AVANCOHET NË GRADË GJENERALLEJTËNANT



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, njëherësh komandante supreme e Forcave të Sigurisë së Kosovës, në muajin nëntor ka emëruar gjeneralmajor Bashkim Jasharin Komandant të ri të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në përputhje me kompetencat kushtetuese.

Emërimi është bërë siç parashihet në Ligjin për FSK-në, pas propozimit të ministrit të Mbrojtjes dhe rekomandimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Para emërimit të Komandantit të ri të FSK-së, Presidentja e Republikës së Kosovës, mbështetur në dispozitat ligjore, ka

dekretuar lirimin nga detyra të Komandantit të mëhershëm të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas paraqitjes së dorëheqjes nga ana e tij.

Më pas, në muajin dhjetor, Presidentja e Republikës së Kosovës në një ceremoni të veçantë shtetërore, gradoi Komandantin e FSK-së, gjeneral major Bashkim Jasharin, në gradën Gjenerallejtënant.



INTERESIMI I GRAVE DHE VAJZAVE PËR TË QENË PJESË E FSK-SË NË RRRITJE GJATË VITIT 2021



Trendi në rritje të interesimit të grave dhe vajzave për tu bërë pjesë e FSK pasqyron më së miri ngritjen graduale të vetëdijesimit se ushtria nuk është vetëm për burra.

Aktualisht në FSK janë rreth 11 % e pjesëtarëve të FSK-së, gra dhe vajza pa dallim etnie, që mbajnë të veshur uniformën e FSK dhe performojnë me të njëjtin nivel të profesionalizimit, ashtu si edhe kolegët e tyre.

Tregues i rëndësishëm për përfshirjen e grave në çështjet e sigurisë nuk është vetëm numri i tyre në FSK, por cilësia dhe niveli i përfaqësimit të tyre në strukturat e FSK.

Grada më e lartë e gruas në uniformë në FSK është Gjeneral Brigade, e cila udhëheq njërin nga katër komandat e FSK-së, respektivisht është Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu.

Po kështu janë edhe katër gra në gradën e nënkolonelit, pesë majorë, gjashtë kapitene si dhe me pozita në -rangjet dhe gradat e tjera të FSK.

Në Ministrinë e Mbrojtjes aktualisht nëpunës civil janë 31 % gra dhe vajza dhe 69% djem dhe burra. Ministri Mehaj është i përkushtuar që ky numër të rritet me qëllim që të kemi një përfaqësim sa më të mirë të grave dhe vajzave në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK.

PAQJA DHE SIGURIA E QËNDRUESHME GARANTOHEN VETËM ME PJESËMARRJE TË PLOTË E TË BARABARTË TË GRAVE

Në shënimin e përvjetorit të Rezolutës 1325 të KS të OKB, me 19 nëntor, Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me UN-Women ka mbajtur konferencë me temën "Gratë, Paqja dhe Siguria". Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, gjatë fjalimit të saj në përvjetorin e 21-të të Rezolutës 1325 të OKB-së, është shprehur e bindur se pa pjesëmarrje të plotë e të barabartë të grave, nuk do të mund të garantohet asnjëherë paqja dhe siguria e qëndrueshme.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj është shprehur se progresi i përgjithshëm shtetëror, qytetar dhe shoqëror, bazohet në fuqizimin dhe kultivimin e vlerave tona unike të diversitetit gjinor, etnik, fetar e kulturor.



NGJARJE HISTORIKE- FLAMURI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS U NGRIT NË MISIONIN E PARË PAQERUAJTËS TË FSK-SË NË KUVAJT

Suksesi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës që ka shënuar vitin 2021, ka qenë bashkëpunimi bilateral me partnerin tonë kryesor strategjik Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe partneriteti me Gardën Kombëtare të Iowa-s. Si rezultat i kësaj, në muajin maj kontingjenti i FSK-së ka zbarkuar në Kuvajt së bashku me Gardën Kombëtare të Iowa-s.

Flamuri i Republikës së Kosovës për herë të parë u ngrit në misionin paqësor të FSK-së në Kuvajt, si anëtar i koalicionit në Forcën e Përbashkët e Kombinuar (Inherent Resolve). (2 qershor 2021).

Me këtë është treguar se Kosova është e përkushtuar për paqe dhe siguri në mbarë botën.

Në Ministrinë e Mbrojtjes është mbajtur ceremonia e ndarjes së medaljeve për pjesëtarët e FSK-së të kthyer pas përfundimit të misionit të tyre në operacionin paqeruajtës dhe të stabilitetit përkrahë forcave amerikane të Gardës Kombëtare të IOWA-s në Lindjen e Mesme në Kuvajt, gjatë periudhës kohore maj-tetor 2021.

Me këtë rast, zëvendësministri i Mbrojtjes,

Shemsi Sylja, ndau medaljet “Pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare” të akorduara nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj për: major Mentor Ibrahim, kapiten Kreshnik Haxhiu, toger Dhurim Shemsedini, tetar Hynor Lajqi dhe ushtar Mehmet Mehmeti. Kurse medaljet për “Shërbim të Shquar” ai i ndau pjesëtarëve nga Garda Kombëtare e Iowa-s, kapiten Wesley R. Gudenkauf dhe rreshter i klasit të parë Matthew G. Sandersen.

Bashkë zbarkimin e ka mundur edhe angazhimi dhe marrëveshja me Gardën Kombëtare të Iowa-s dhe Marrëveshja për Lëvizjen e Trupave-SOFA, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kuvajtit, në tetor 2021.



PËRFAQËSIM DINJITOZ NDËRKOMBËTAR I LIDERSHIPIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE FSK-SË

Ministri i Mbrojtjes dhe Komandanti i FSK-së, në kuadër të përgjegjësiave zyrtare, kanë vazhduar me aktivitetet e përfaqësimit ndërkombëtar gjatë gjithë vitit.

Një ndër ngjarjet më të spikatura është pjesëmarrja në ceremoninë e hapjes së ekspozitës vjetore të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (The Association of the United States Army) – “AUSA 2021”.

Në kuadër të takimeve të nivelit të lartë, ministri Mehaj është pritur dhe ka takuar autoritetet e larta të Departamentit të Mbrojtjes,



Departamentit të Shtetit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare që është pjesë e Zyrës Ekzekutive të Presidentit të SHBA-së.

Vlen të cekem, takimet me:

Zëvendës ndihmës-sekretarin amerikan për Çështje të Evropës dhe Euroazisë, njëherit të dërguarin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Drejtoreshën për Ballkan dhe Evropë Qendrore të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, znj. Robin S. Brooks.

Nën-Sekretarin e Departamentit të Mbrojtjes, Dr. Colin Kahl.

Shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare, Gjeneral Daniel R. Hokanson.

Zv. Asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes, znj. Laura Cooper.

Drejtoreshën e Agjencisë së Bashkëpunimit të Sigurisë së Mbrojtjes të Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së, znj. Heidi Grant.

Në kuadër të takimeve të nivelit të lartë, ministri Mehaj është pritur në takim zyrtar në Pentagon nga Nën-Sekretari i Departamentit të Mbrojtjes, Dr. Colin Kahl, pastaj në Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-së në Pentagon, ai ka takuar Shefin e Byrosë së Gardës Kombëtare, Gjeneral Daniel R. Hokanson, si dhe ka realizuar takimin me zv. Asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes, Laura Cooper dhe më pas në nivel të delegacioneve janë realizuar konsultimet bilaterale për çështjet e mbrojtjes.





-Ndër të arriturat më të mëdha gjatë këtij viti në aspektin e përfaqësimit ndërkombëtar, qoftë edhe përmes platformave virtuale, si dhe në aspektin e vizitave e takimeve reciproke me palët e partnereve respektive të lidershit të MM dhe FSK, vlen të theksohen:

Vizitat e ministrit Armend Mehaj në Mbretërinë e Bashkuar;

Vizita në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kroacisë;

Vizita në Republikën Federale të Gjermanisë,

Vizita në Republikën e Turqisë,

Vizita në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

Pjesëmarrja në Forumin e Halifax të Kanadasë,

Pjesëmarrja në konferencën e US-Adriatic Charter (A5),

Pjesëmarrja e ish-komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në konferencën e Shefave të Mbrojtjes në kuadër të US-Adriatic Charter (A5) në shtator 2021; Pjesëmarrja e ministrit Mehaj dhe Gjeneral Ramës në panairët e ISOA në SHBA, IDEF në Turqi dhe ASDA në Kroaci;

Pjesëmarrja e ministrit Mehaj në iniciativën e Bashkëpunimit të Mbrojtjes për Evropën Qendrore (Central European Defence Cooperation CEDC), etj.





-Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në gjatë vitit kanë vizituar edhe personalitete të larta nga vendet tona partnere. Ndër vizitat më të veçanta gjatë vitit 2021 ishin: vizita e Gjeneralit historik amerikan, Wesley Clark vizita zyrtare e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, Niko



Peleshi; ministrit të Mbrojtjes të Letonisë, Artis Pabriks; ministrit të Mbrojtjes së Hungarisë, Tibor Benko; ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Mario Banozic; ministrit të Mbrojtjes së Sllovenisë Matej Tonin dhe ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, Hulusi Akar.

Vlen të ceket edhe takimi virtual i ministrit Mehaj me ish-sekretaren historike amerikane të shtetit, Madeleine Albright si dhe takimi i ministrit Mehaj me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.





THELLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Në planin e bashkëpunimit bilateral, Ministria e Mbrojtjes përmes strukturave të saj ka koordinuar dhe realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara dypalëshe për vitin 2021.



Edhe këtë vit, u organizua konferenca vjetor tradicionale “FSK dhe partnerët 2021”.

Pjesëmarrës në këtë Konferencë ishin ambasadorë, atashe të mbrojtjes dhe përfaqësues të ambasadave të vendeve partnere të cilët shprehën fuqishëm zotimin për vazhdimin dhe forcimin e partneritetit tonë edhe në të ardhmen.

Gjatë këtij viti Ministria e Mbrojtjes ka nënshkruar marrëveshje të reja të bashkëpunimi si në vijim: me Mbretërinë e Bashkuar; me Republikën e Shqipërisë; me Letoninë; me Kroacinë; me Maqedoninë e Veriut.

Takimi bilaterale për koordinim të planeve të bashkëpunimit janë realizuar edhe me Bundeswehriin gjerman dhe me Shtabin e Përgjithshëm të FA të Italisë.



PËRVJETORI I 23-TË I EPOPESË SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, me 5 mars është shënuar 23 vjetori i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



FSK SHEMBULL I PËRKUSHTIMIT DHE ANGAZHIMIT PROFESIONAL NË OPERACIONIN HUMANITAR PËR PRITJEN E REFUGJATËVE AFGANË

FSK me aftësitë dhe kapacitetet e specializuara operacionale të saj, prej datës 29 gusht të këtij viti, është e angazhuar në operacionin humanitar shumëkombësh të NATO-s të udhëhequr nga SHBA, për transportin, pritjen, akomodimin dhe sigurinë e refugjatëve afgan.

Ministria e Mbrojtjes ka angazhuar efektivat e specializuar të rendit, sigurisë, mjekësisë, të mbështetjes logjistike dhe transportit të FSK-së në kuadër të Task-Forcës së përbërë nga institucionet qeveritare vendore, si pjesë e operacionit përkatës. Besimi i partnerëve tanë strategjik në aftësitë dhe profesionalizimin e FSK-së, për të qenë pjesë e operacionit të përbashkët, është shumë domethënës.



DONACIONET SI TREGUES I FUQISHËM I PËRKUSHTIMIT TË SHTETEVE MIKE

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së gjatë vitit janë mbështetur fuqishëm nga shtete mike përmes arsimimit, stërvitjeve, si dhe donacioneve.

Gjatë këtij viti, partneri ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u kanë dhuruar forcave tona të armatosura 55 automjete ushtarake në vlerë të madhe, të cilat do t'i ndihmojnë forcat tona të forcojnë më kapacitetet e veta dhe ta thellojnë edhe më tej ndërveprimin e ushtrisë sonë në ushtritë aleate;

Republika e Turqisë ka dhuruar donacion në vlerë prej 1.3 milionë dollarë për vitin 2021; Me qëllim të përballimit të pandemisë COVID-19, Mbretëria e Norvegjisë ka dhuruar 100 respiratorë mjekësorë për Qendrën Mjekësore të FSK-së;





Gjermania ka vazhduar mbështetjen konkrete për modernizimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së me donacionin në vlerë prej 1 milion euro duke përfshirë pajisje, automjete dhe trajnime të specializuara të fushës së EOD-së dhe HAZMAT-it.



NGA VITI I ARDHSHËM, MINISTERIA E MBROJTJES DO TË KETË MBI 100 MILIONË EURO NË BUXHETIN E SAJ

Ministri Armend Mehaj, ka theksuar se me rritjen e konsiderueshme të buxhetit, po tregohet përkushtim që Kosova të ketë një ushtri moderne dhe me standarde të NATO-s, e cila do jetë e gatshme për mbrojtjen e vendit.

Departamenti për Menaxhimin e Financave i Ministrisë së Mbrojtjes gjatë vitit 2021 ka arritur të realizojë me sukses shumicën dërmuese të aktiviteteve të parapara.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR MM/FSK PËR VITIN 2021

Gjatë vitit 2021 buxheti i planifikuar për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në është realizuar mbi 95 për qind.

INSPEKTIMI DHE MBIKËQYRJA E SUKSESSHME E ZBATUESHMËRISË SË DETYRIMEVE LIGJORE DHE OPERACIONALE NË MM DHE FSK

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, përmes Inspektoratit të FSK-së, sipas përgjegjësi dhe planit të saj, ka bërë mbikëqyrjen e suksesshme në zbatimin e efektshmërisë së detyrave ligjore si dhe procedurave administrative dhe operacionale në të gjitha nivelet e MM-së dhe FSK-së.

Kjo është bërë me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të burimeve njerëzore, në hap me ndryshimet dhe standardet si dhe të mbikëqyrjes në kryerjen e detyrave profesionale dhe ligjore.



AUDITIMI I BRENDSHËM ME NDIKIM TË LARTË PËR LLOGARIDHËNIE PARA PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESIT



Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2021 ka qenë mjet i frytshëm dhe ka ndihmuar Ministrinë e Mbrojtjes përmes dhënies së rekomandimeve në aspektin e pajtueshmërisë dhe llogaridhënës. Gjithashtu është treguar efektiv për të vlerësuar sistemin e kontrollit dhe ka ndihmuar qeverisjen e mirë përmes rreziqeve që ju kanoset sistemeve.

Pra, qëllimi i Auditimit të Brendshëm është për ta bërë më efektive qeverisjen dhe përcakton faktorët kryesor që nevojiten për të shtuar siguri në qeverisjen e Ministrisë së Mbrojtjes.

BLERJET E REJA, NGRITJA E KAPACITETEVE LOGJISTIKE DHE INFRASTRUKTURE NË FUNKSION TË ARRITJES SË AFTËSIVE OPERACIONALE TË FSK

Gjatë vitit fiskal 2021 janë zhvilluar aktivitet e prokurimit në përputhje me kërkesat dhe planin e prokurimit dhe janë realizuar procedurat e prokurimit ku janë nënshkruar kontrata sipas legjislacionit në fuqi për kontratat me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale. Gjithsej janë nënshkruar 44 kontrata ku prej tyre 8 kontrata janë me vlerë të madhe, 22 kontrata janë me vlerë të mesme, me vlerë të vogël janë nënshkruar 2 kontrata dhe kontrata me vlerë minimale janë nënshkruar 12. Në pritje për nënshkrim të kontratës janë 4 me vlerë të madhe, 3 me vlerë të mesme dhe 2 me vlerë të vogël.



INFRASTRUKTURA LIGJORE-KUSHT PËR FUNKSIONIM EFIKAS

Edhe gjatë vitit 2021, lidershipi i Ministrisë së Mbrojtjes ndër prioritetet e saj për vitin 2021 ka pasur përmbueshje e programit legjislativ, hartimit të akteve nënligjore, sipas planit legjislativ të akteve nënligjore të MM për vitin 2021.

Në mbledhjen e Kuvendi i Kosovës të mbajtur më 13 dhjetor është miratuar në shqyrtim të dytë Projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Gjithashtu, duke u bazuar në Programin Legjislativ 2021 të Qeverisë nga Ministria e Mbrojtjes janë hartuar dhe proceduar për miratim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për Deminim Humanitar ndërsa hartimi i Projektligjit për Policinë Ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Projektligji për Ratifikimin e Këmbimit të Notave Diplomatie; Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për Statusin e Pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimin të tyre të përkohshëm në Territorin e Shteteve Përkatëse;

Gjatë vitit 2021 janë hartuar dhe miratuar rregulloret në vijim: për rekrutim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, për pushimet në FSK, për zhvillimin e karrierës së pjesëtarëve të FSK-së dhe për të dhënat personale dhe dosjen e personelit në MM dhe FSK.



INTEGRIMI I KOMUNITETEVE JOSHUMICË, OBJEKTIV I PËHERSHËM I LIDERSHIPIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE FSK



Integrimi, zhvillimi dhe mbajtja e qëndrueshme e komuniteteve jo shumicë në FSK ka vazhduar të jetë objektivë e udhëheqjes së Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK për gjatë vitit që lamë pas.

Njësia për Çështjen e Komuniteteve në periudhën kohore janar- mars 2021 ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë në MM/ FSK i cili është miratuar nga ministri Mehaj më datën 8 mars 2021. Me këtë Strategji MM ka vizion afatgjatë që të integrojë, zhvillojë dhe të motivojë komunitetet jo shumicë brenda FSK-së.

Bashkëpunimi me institucionet dhe disa

komuna të banuara me komunitetet jo-shumicë ka vazhduar të jetë i ngushtë edhe gjatë vitit 2021.

Gjithashtu NJÇK ka zhvilluar takimet të rregullta me komunitete jo-shumicë në njësitet e FSK-së. Gjatë tërë kësaj kohe NJÇK ka pasur një bashkëpunim dhe mbështetje të fuqishme nga NALT si dhe OSBE ku kjo e fundit ka financuar projektin “Promovimi dhe qasja në të drejtat e komuniteteve”.

POLITIKAT DHE PLANET STRATEGJIKE TË EFTEKSHME NË ZHVILLIM TË MBROJTJES

Politikat bashkëkohore të mbrojtjes dhe sigurisë të NATO-s dhe BE-së janë fokusi dhe objektivi i përhershëm strategjik sa i përket spektrit të zhvillimit të politikave të planeve strategjike dhe operacionale të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë vitit 2021, janë realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Planit Vjetor të Punës së Ministrisë së Mbrojtjes në zhvillimin dhe hartimin e politikave. Në fillim të vitit 2021, pikërisht në muajin shkurt, Strategjia e Mbrojtjes është hartuar dhe miratuar nga Kryeministri i RKS-së. Po ashtu, janë nënshkruar Qëllimet Strategjike dhe Objektivat Operacionale të Ministrit të Mbrojtjes 2021 - 2025 dhe Udhëzuesi për Hartimin e Politikave Nën Sektoriale në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe Hierarkia e Dokumenteve në Ministrinë e Mbrojtjes.



BASHKËPUNIM I NGUSHTË DHE I SHUMËANSHËM CIVILO - USHTARAK

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK ka qenë në përkushtuar në vazhdimin e bashkëpunimit të shkëlqyeshëm civilo- ushtarak, ku veçojmë ato me institucionet shkollore dhe parashkollore, të cilat kanë shprehur interesimin të shohin nga afër FSK-në dhe pjesëtarët e saj. Gjithashtu, të gjitha kazeramat e FSK-së kanë qenë të hapura për vizitorët me rastin e “Ditës së Forcës”, më 27 Nëntor.



FSK ka realizuar gjithsej 13 aktivitete për projekte në mbështetje të institucioneve të ndryshme si për Policinë e Kosovës në disa raste gjatë vitit ka mbështetur transport me xheniere, tenda dhe pajisje tjera, për Komunën e Gjakovës ku FSK me transport ka bërë bartjen e garuesve për realizimin e garës tradicionale në skijim “Kupa e Gjeravicës” në nivel ndërkombëtar në Bjeshkët e Belegut.

Gjithashtu, FSK me ekipin mjekësor ka mbështetur pjesëmarrësit në aktivitetin e të Minimarratonës Humanitare 5km, me moton “Vrapo për Sindrom Down Kosovën” si dhe për Federatën e Çiklizmit të Kosovës me rastin e organizimit të Garës Ndërkombëtare “Tour of Kosova” etj.



Në koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe SHPFK për realizimin e ligjëratave për vetëdijesim nga rreziku i mjeteve piroteknike nga Instruktorë e Deminimit, në shkollat e Republikës së Kosovës, në prag të festave të fund vitit të filluara, si dhe harmonizimin e planit të ligjëratave për vetëdijesim nga mjetet e pa shpërthyer (MINAT), që do të realizohen nga Instruktorët e Deminimit të FSK-së nga gjysma e janarit 2022.



PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUSHT PËR PUNË EFEKTIVE

Gjatë vitit 2021, Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim ka realizuar me sukses aktivitetet e parapara në Planin Vjetor të Veprimit për Ministrinë e Mbrojtjes dhe në kuadër të Planit të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Bazuar në Objektivat Strategjike Vjetore të Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2021 dhe dokumenteve tjera relevante është koordinuar hartimi i Planit të Ministrisë së Mbrojtjes 2021-2023, ndërsa bazuar në programin qeveritar 2021-2025 të Qeverisë së Kosovës është hartuar edhe Plani i Punës për Qeverinë e Republikës së Kosovës (2021-2024) nga fushëveprimi i Ministrisë së Mbrojtjes.

TRANSFORMIMI, MODERNIZIMI DHE STANDARDIZIMI-BAZË E USHTRIVE MODERNE

Gjatë vitit 2021 janë finalizuar tri standarde ushtarake: për pajisjet individuale të njësive të FSK-së, për standardin mjekësor në FSK dhe për fitnesin fizik.

Gjithashtu janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshëm që Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës në vitin 2022 të startojë me sistemin e PPBE dhe futjen në jetë të Programeve të Mbrojtjes, Nën Programeve dhe Element-Programeve.



PROCESI I REKRUTIMIT NË FSK- SUKSES I MADH ZBATIMIN E PLANIT TË TRANZICIONIT PËR FAZËN E PARË

Procesi i përzgjedhjes së rekrutëve aktivë i filluar në vitin 2020 i cili për shkak të pandemisë COVID-19 ka zgjatur deri në vitin 2021, përfundimi i të cilit ka rezultuar me përzgjedhjen e 404 rekrutëve prej të cilëve 28 femra dhe 3 pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë. Rekrutët e përzgjedhur janë ndarë në dy gjenerata për trajnim bazik, gjenerata e parë ka përfunduar ndërsa gjenerata e dytë përfundon trajnimin në javën e tretë të muajit dhjetor 2021. Janë themeluar Bordi Përzgjedhës, Ekipi mbikëqyrës për monitorimin e procesit të testimit, dhe ka filluar procesi i testimit në testin e Fitnesit Fizik.

Gjatë vitit 2021 zhvillimi i politikave të personelit, rekrutimeve të stafit civil, kadetëve, rekrutimit të rekrutëve të FSK-së si dhe planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, kanë qenë aktivitete parësore.



ARSIMIMI DHE STERVITJA - ME PRIORITET TË LARTË PËR PROFESIONALIZMIN E PJESËTARËVE TË FSK-SË

Shkollimi për këtë vit në QSU janë duke i ndjekur 68 kadetë ndërsa në shkollime jashtë vendit janë 42 kadetë. Gjatë vitit jashtë vendit janë mbajtur 70 trajnime, ku kanë marrë pjesë 156 pjesëtarë/zyrtarë. Në trajnime të brendshme kanë marrë pjesë 1478 pjesëtarë në 68 trajnime/kurse të ndryshme. Në gjashtë ushtrime fushore jashtë vendit kanë marrë pjesë 65 pjesëtarë. Janë realizuar pesë gara të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë 38 pjesëtarë. Në trajnimet me IKPA/CIDS kanë marrë pjesë 222 zyrtarët/pjesëtarët e MM/FSK



BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME INSTITUCIONE VENDORE NË FUSHËN E MJEKËSISË-AVANCIMI KAPACITETEVE MJEKËSORE NË FSK



Për shkak të pandemisë COVID 19 Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht Departamenti i Mjekësisë ka qenë pjesë e komiteteve për menaxhimin e situatës së pandemisë COVID 19, si në nivel ndërministror pjesë e Komiteti për koordinim dhe vlerësim të situatës me COVID 19 ashtu edhe në IKSHPK si pjesë e Komiteti për sëmundje ngjitëse, dhe në shërbimin spitalor Klinik Universitar të Kosovës si pjesë e Komisionit për riorganizimin e klinikave për shkak të pandemisë COVID 19. Departamenti i Mjekësisë në bashkëpunim me Klinikën e Psikiatrisë ka organizuar trajnimin “Shëndeti Mendor dhe Mirëqenia”, ku kanë marrë pjesë 15

pjesëtarë të FSK-së. Ndërsa në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJK) ka organizuar aktivitetin për dhurimin vullnetar të gjakut në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK, si dhe në aspektin logjistik e ka mbështetur Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) në të gjitha aksionet e dhurimit vullnetar të gjakut në nivel vendi.

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Mjekësisë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mjekësisë. Marrëveshja është nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu është nënshkruar Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.



DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT



Edhe këtë vit ka vazhduar tradita e suksesshme e realizimit të aktivitetit “Dhurimi Vullnetar i Gjakut” në MM/FSK, i filluar nga data 26 korrik dhe i përfunduar me 17 gusht, ku për nevojat e QSKUK-së janë dhuruar 522 doza gjak.

DIPLOMOJNË MJEKËT E PARË TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Gjatë këtij viti, në procesin e ngritjes së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme të mbështetjes operacionale FSK-së i janë shtuar kapacitetet profesionale mjekësore ushtarake. Në qershor të 202, katër kadetë të FSK-së kanë diplomuar në kuadër të 112 studentëve të cilët diplomuan në Universitetin e Shkencave Mjekësore.

ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I MËTEJMË I SISTEMEVE TË KOMUNIKIMIT DHE TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Me qëllim të mbajtjes, zhvillimit, profesionalizimit të kapaciteteve dhe gatishmërisë operacionale të komunikimit në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK janë realizuar: Plotësim-ndryshimi i Strategjisë për Siguri Kibernetike në MM/FSK dhe draft Plani i Veprimit 2021-2023; Angazhimi në kuadër të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për hartimin të Strategjisë Shtetërore për Siguri Kibernetike; Planifikimi i ushtrimit të përbashkët të FSK-së dhe ushtrisë kroate me vendet partnere respektive (IOWA dhe Minnesota) në fushën e sigurisë kibernetike; Pjesëmarrja në ushtrimin në fushën e sigurisë kibernetike A5+ të organizuar nga USEUCOM, në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha vendet e Ballkanit me vendet partnere respektive.



SHËRBIMI I INTELIGJENCËS DHE SIGURISË GARANCË E PLOTË PËR FUNKSIONIMIN E MINSITRISË SË MBROJTJES DHE OPERACIONALITETIN EFIKASTË FSK-SË



Edhe gjatë këtij viti, komponentet përgjegjëse kanë realizuar sistematikisht mbledhjen e informacioneve, përpunimin, analizimin dhe përgatitjen e produkteve të inteligjencës për leadershipin e MM dhe FSK në mbështetje të vendimmarrjes së tyre. E gjitha kjo është arritur në vazhdimësi duke siguruar një vlerësim të të dhënave nga një varg burimesh, të orientuara drejt përgjegjjes së Kërkesave Prioritare të Inteligjencës me fokus në planifikimin strategjik dhe operacional në mbështetje të misionit të MM dhe FSK. Po ashtu janë hartuar edhe vlerësimet për rreziqet e mundshme në vend dhe rajon.

Gjatë kësaj periudhe, strukturat e DGA-së, kanë vazhduar bashkëpunimin dhe aktivitetet bilaterale me strukturat e

inteligjencës dhe sigurisë në vend si Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Policinë e Kosovës (PK), KFOR etj.

Është punuar në Hartimin e Koncept dokumentit dhe Draft Ligjit për formimin e Agjencisë së Mbrojtjes për Inteligjencë dhe Siguri.

FSK PËR DHJET VJET MË RADHË VLERËSOHET INSTITUCIONI MË I BESUESHËM I SIGURISË

Forca e Sigurisë së Kosovës edhe këtë vit doli të jetë institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend për qytetarët e Kosovës, me nivel edhe më të lartë se viteve tjera, me 82% të besueshmërisë qytetare. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka konfirmuar se anketimi i parë matë perceptimet e qytetarëve lidhur me besueshmërinë në institucionet e sigurisë, drejtësisë, si dhe në institucione të nivelit qendror dhe lokal, anketimi tjetër interpreton perceptimet e qytetarëve lidhur me korrupsionin në këto institucione.

Edhe në këtë aspekt, Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas këtij barometri, shihet si institucioni më së paku i korruptuar në nivel të Kosovës.

Ky rezultat padyshim është pasqyrim i zbatimit të duhur të objektivave me përkushtim të lartë udhëhequr nga parimi i t r a n s p a r e n c ë s dhe llogaridhënies të plotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.



KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIAT ME PROFESIONALIZËM DHE OBJEKTIVITET TË PLOTË

Një prej 5 objektivave të ministrit të Mbrojtjes për vitin 2021 ishte edhe Rritja e transparencës, objektiv për të cilin Ministria e Mbrojtjes ka bërë angazhimet maksimale për të realizuar detyrat që dalin nga fusha e informimit dhe marrëdhënieve me publikun. Realizimi i këtyre detyrave është bërë për mes aktiviteteve të shumta.

Gjatë këtij viti janë realizuar tri fushatat mediale. Gjithashtu, gjatë këtij viti Zyra për Marrëdhënie me Publikun ka publikuar 296 komunikata për media, njoftime dhe ftesa për media. Leje të proceduara nga ZMP në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Informim Publik të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së janë 70 leje; 4 TV-spote dhe radio-spote në dy gjuhët zyrtare; 292 prononcime për media, radio dhe televizione si dhe 13 përgjigje me shkrim në pyetje të mediave qasje në dokumente zyrtare; Publikimi i Revistës së ilustruar me të arriturat kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për vitin 2021"; 3 publikime të Buletinit informativ (Newsletter), botim në gjuhën angleze në versionin elektronik.

Pastaj aktivitete ditore të vazhdueshme si: monitorime, analiza, furnizim me materiale i ueb-faqes zyrtare të Ministrisë dhe në rrjetet sociale Facebook, Flickr, Youtube dhe Twitter; raportime të aktiviteteve dhe shoqërime të liderëve dhe stafit të lartë në aktivitete protokollare etj.

Angazhimi dhe përkushtimi i lartë në kryerjen e detyrave të stafit të ZMP, ka bërë që edhe këtë vit, FSK të jetë institucioni i sigurisë më i besueshëm në vend.




PROTOKOLLI INSTITUCIONAL DHE SHTETËROR ME STANDARD TË LARTË

Njësia e Protokollit e Ministrisë së Mbrojtjes gjatë vitit 2021 ka zbatuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë specifike në organizimin e pritjeve për autoritetet ndërkombëtare për vizitat në Ministri të Mbrojtjes dhe FSK.

Gjithashtu ka bërë harmonizimin dhe koordinimin e vizitave në MM dhe SHPFK. Në bashkëpunim me kabinetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Komandantit të FSK-së, janë hartuar programet e vizitave të tyre dhe përgjigjet për zbatimin e tyre.







REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSO

MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTARSTVO ODBRANE - MINISTRY OF D



BOTUES:

Ministria e Mbrojtjes
Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Adresa: Ministria e Mbrojtjes
Kazerma "Adem Jashari" Prishtinë
Tel: 038551 379
web: mod.rks-gov.net;

